



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.443/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fatmir Bllacës, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, për shkak të keqpërdorimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL.Anr.443/2017 e datës 23.10.2017 e Fatmir Bllacës, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 23.10.2017 nga Fatmir Bllaca, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, me të cilën kërkon që të rinumërohen votat e tij, ngaqë sipas parashtruesit të ankesës, ai ka marr premtime nga miqtë dhe familjarët se do ta votonin, ndërsa nga numri i vogël i votave në total, rezulton se në 45 kuti të votimeve i janë keqpërdorur votat.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesën përkitazi me keqpërdorimin e votave në vendvotimet e cekura në ankesë, për faktin se shkeljet që ndërliidhen me rezultatin e votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi për shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hedh si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës të ankuesit nuk e paragjykon çështjen se ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

Zl.Anr. 443/2017 me datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Paneli

Zyhdi Haziri



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-